



Av Rigels DERVISHI

Rruga Onhezmi 4

Sarandë 9702

Albania (AL)

+355 69 69 10 513

✉ avv.rigelsdervishi@hotmail.com

Nr. prot

Sarandë më 09.06.2025

Ankim

Ankues: Av. Rigels Dervishi, banor i qytetit të Sarandës, Anëtar i Dhomës së Avokatisë Sarandë me nr. License 9315, adresa lagjja Nr.1 Sarandë, Rruga "Onhezmi" nr 4 godinë 6 katëshe, pranë Gjykatës Sarandë.

Objekti: Ankim kundër vendimit nr. datë 30.05.2025 të Këshillit Bashkia Sarandë, Për realizimin e miratimin e "*Marrëveshjes Bashkëinvestimit*" midis Fondit Shqiptar të Zhvillimit, person juridik shqiptar dhe Bashkisë Sarandë, person juridik publik, për realizimin e projektit "*Poli i Zhvillimit Turistik Sarandë*" si një vendim i paligjshëm dhe në kundërshtim me interesin publik.

Baza Ligjore: Ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore" Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë".

Neni 3 i Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Nenet 66,80,105 e vijues i Kodi Procedures Administrative .

Drejtuar: Prefektit të Qarkut Vlorë
Z. Plator Nesturi

Z.Kryetar!

Jemi vënë në dijeni nëpërmjet medias lokale Saranda Web se në datën 29.05.2025 , në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Sarandë si rend të ditës ka patur, miratimin e "*Marrëveshjes Bashkëinvestimit*" midis Fondit Shqiptar të Zhvillimit, person juridik shqiptar dhe Bashkisë Sarandë, person juridik publik, për realizimin e projektit "*Poli i Zhvillimit Turistik Sarandë*"

Për shkak se çështja ka interes publik, unë si avokat duke qenë se jam banorë i qytetit të Sarandë, në bazë të ligjit nr.55/2018 "*Për Profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë*" nenet 6 e 11. Neni 23 i "*Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë*", Neni 3 i Ligjit nr.119/2014 "*Për të drejtën e informimit*" i kam kërkuar në datën 31.05.2025 Këshillit Bashkiak Sarandë informacion si më poshtë:

"1.Nëse vendimi i Këshillit Bashkiak i datës 30.05.2025 është marrë ose jo pas konsultimit publik për transparencë me banorët apo grupet e interesit siç përcakton neni 16 i ligji 139/2015 "*Për vetëqeverisjen Vendore*"

2.A janë ndjekur procedurat ligjore nga ana e Këshillit të parashikuara nga ligji 8743/2001 "*Për pronën publike dhe private të shtetit*" dhe aktet nënligjore në fuqi për administrimin e pasurive publike.

3.A cënon vendimi i Këshillit Bashkiak parimet e mirëqeverisjes, interesit të përbashkët dhe a ka pasojë sociale, ekonomike mjedisore për komunitetin.

4. Të na vihen në dispozicion lista e emrave të Këshillit Bashkiak Sarandë që kanë qenë të pranishëm në mbledhje, dhe emrat e anëtarëve të Këshillit Bashkiak që kanë votuar pro dhe kundër miratimit të këtij vendimi, me qëllim për të ndjekur rrugën ligjore në rast se ka elementë të shpërdorimit të detyrës nga ana e tyre, me pasojë ushtrimin e kallzimit penal pranë organeve kompetetente.

5. Të na vendoset në dispozicion kopje të vendimit të Këshillit Bashkiak, dhe të gjithë dosjen që ka të bëjë me vendimarrjen e mësipërme për ta ankimuar atë sipas ligjit”

Këshillit Bashkiak Sarandë edhe pse ka marrë dijeni nuk ka kthyer përgjigje dhe nuk na ka vënë në dispozicion dokumentacionin dhe informacionin e kërkuar, ndaj po paraqesim këtë ankim brenda afatit ligjor, bazuar vetëm mbi dokumentacionin që kemi mundur të sigurojmë në bazë të nenit 14 dhe 73 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, kundër vendimit të Këshillit Bashkiak Sarandë me nr.– Datë 30.05.2025 që lidhet me miratimin e “Marrëveshjes Bashkëinvestimit” midis Fondit Shqiptar të Zhvillimit, person juridik shqiptar dhe Bashkisë Sarandë, person juridik publik, për realizimin e projektit “Poli i Zhvillimit Turistik Sarandë”.

I. Shkaqet e këtij ankimi janë si më poshtë:

1. Nga ana e Këshillit Bashkiak Sarandë është vepruar në kundërshtim me ligjin 146/2014 “Për konsultimin publik”. Ky ligj detyron institucionet publike që të konsultojnë publikun për ndryshimin e destinacionit referuar kësaj marrëveshje.

Vendimi i Këshillit Bashkiak Sarandë datës 30.05.2025 është marrë pa konsultimin publik për transparencë me banorët apo grupet e interesit siç përcaktojnë nenet 16, 17 i ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

2. Nga ana e Këshillit Bashkiak Sarandë është vepruar në kundërshtim me ligjin “Për arsimin Parauniversitar” nr.69/2012, pasi objektet dhe trualli i tyre janë të dedikuara për funksion arsimor dhe nuk mund të ndryshohet qëllimi i përdorimit pa vendim të arsyetuar dhe pa miratimet e nevojshme nga Ministria e Arsimit që në këtë rast nuk është marrë.

3. Ndërtesa Eco Kampus si dhe trualli përreth është pasuri publike me funksion Shkollë Publike dhe përdorimi i truallit përreth për qëllime të tjera bie në kundërshtim me interesin publik. Këshilli Bashkiak Sarandë duke marrë parasysh faktin se në qytetin e Sarandës ka dy shkolla 9-Vjecare , dhe mësimi në shkolla bëhet me dy turne , duke parë nevojat në rritje të popullsisë nuk mund që të kalojë as objektin dhe as truallin një institucioni tjetër për hoteleri, ku sipërfaqja e truallit mund të shërbejë si kënd lojrash për fëmijë, ndërtimin e strukturave sportive, fusha futbollit, basketbolli, pishina publike si dhe parqe rekreative dhe argëtimi për komunitetin.

4. Nga ana e Këshillit nuk janë ndjekur procedurat ligjore të parashikuara nga ligji 8743/2001 “Për pronën publike dhe private të shtetit” dhe aktet nënligjore në fuqi për administrimin e pasurive publike.

5. Vendimi i Këshillit Bashkiak cënon parimet e mirëqeverisjes, interesit të përbashkët dhe ka pasoja sociale, ekonomike, mjedisore për komunitetin.

II. Kërkesat përfundimtare janë si më poshtë.

I nderuar Prefekt!

Duke u bazuar në kompetencat tuaja si përfaqësues i Këshillit të Ministrave në territorin e Qarkut Vlorë dhe si autoritet mbikëqyrës për ligjshmërinë e vendimeve të organeve të qeverisjes vendore, bazuar në nenin 14, 73 të ligjit 139/2015 kërkojmë :



Marrjen në shqyrtim të ankimit duke vendosur nga ana e Juaj:

1. Verifikimin e ligjshmërisë së vendimit të mësipërm të Këshillit Bashkiak Sarandë, dhe mosmiratimin e tij si të paligjshëm.
2. Pezullimin e menjëhershëm të zbatimit të vendimit të Këshillit Bashkiak Sarandë pasi është në kundërshtim me interesin e lartë publik të qytetarëve të qytetit të Sarandës dhe në kundërshtim flagrant me ligjin .
3. Kërkimin e rishqyrtimit të vendimit nga Këshilli Bashkiak dhe shfuqizimin e tij

Në lidhje me kërkesat tona kërkojmë të informohemi me shkrim për ecurinë e trajtimit të këtij ankimi.

Bashkëngjitur kopje të akt-marrëveshjes për investim, pasi dokumentacioni nuk na është vënë në dispozicion nga Këshilli Bashkiak Sarandë. Lutem që dokumentacioni përkatës të kërkohet nga ana juaj sëbashku me gjithë praktikën e ndjekur.

Ju faleminderit!

Ankues
Av. Rigels Dervishi

